

MATËSAT E UJIT, VALVULAT DHE HIDRANTËT

Përshkrimi i kursit

Ky kurs trajnimi do të ofrojë njohuritë e nevojshme mbi matësit e ujit, valvulat dhe hidratët e zjarrit dhe do të shfaq rëndësinë e tyre në sistemin e furnizimit me ujë. Pjesëmarrësit do të kuptojnë sesa i rëndësishëm është funksionimi i rregullt i tyre, përkatësisht, në matjen e saktë të konsumit të ujit, shpërndarjen e tij me presionin e duhur si dhe me një cilësi të mirë.



Përftimet e shumta të matjes, ndërlidhjen e saj me humbjet e ujit, operimi dhe mirëmbajtja e valvulave, si dhe përdorimet e hidratëve të zjarrit në sistemin shpërndarës, do të trajtohen gjerë gjatë këtij kursi trajnimi.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për hidraulikët dhe inxhinierët e operimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit në sistemin e furnizimit me ujë.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Identifikoni dhe të testoni lloje të ndryshëm matësish;
- Identifikoni llojet e matësve elektronike;

- Njihni llojet e valvulave dhe numrin e vendosjes së tyre në një kryqëzim tubacionesh;
- Përcaktoni vendndodhjen e instalimit të valvulave dhe procedurat e nevojshme;
- Identifikoni tipet e hidratëve dhe përdorimin e tyre brenda sistemit shpërndarës;
- Njihni problemet që shkaktohen nga hidratët.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, kompani private që prodhojnë dhe ofrojnë produkte të trajnimit përkatës, do të kryejnë demonstrime të tyre në klasë dhe në terren.



Materialet e kursit të trajnimit

Pjesëmarrësit në këtë kurs trajnimi, do të pajisen me Manualin e Trajnimit "Matësat e Ujit, Valvulat dhe Hidrantët". Përpos kësaj, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 13,000 lekë për person
Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.